





# العَقِيدَةُ الطَّاهِيَةُ



## Akideja Tahauijeh

Me Emrin e Allahut, të Gjithëmëshirëshmit, Mëshirëplotit.

Të gjitha lavdet i takojnë Allahut, Zotit të Gjithësisë.

Tha dijetari i madh, argumenti i Islamit, Ebu Xha'fer el-Uerrak et-Tahauij – në Egjipt – Allahu e mëshiroftë:

🔴 Ky është sqarim i Besimit të Ehli-Sunetit dhe Xhematit sipas medh'hebit të Fukahave të Umetit: Ebij Hanifeh en-Nu'man Ibën Thabit el-Kufij, Ebij Jusuf Ja'kub Ibën Ibrahim el-Ensarij dhe Ebij 'Abdullah Muhamed Ibnul-Hasen esh-Shejbani – Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë ata – dhe çfarë besojnë ata rreth bazave të Fesë, besim me të cilin ata adhurojnë Zotin e Gjithësisë.

## Ne themi për Teuhidin e Allahut<sup>1</sup> duke besuar me sukses (*teufijk*) nga Allahu:

---

### <sup>1</sup> [Komentoi Shejkh 'Abdul-'Aziz Ibën Baz \(rahimehullah\) duke thënë:](#)

“Thënia e tij “ne themi për Teuhidin e Allahut...” e gjer në fund të fjalës së tij: dije se Teuhidi me të cilin Allahu dërgoi të Dërguarit dhe zbriti Librat ndahet në tri kategori, sipas përfundimit të nxjerrë nga studimi i teksteve të Kur'anit dhe Sunetit dhe realitetit të atyre që janë të ngarkuar me detyrat Sheriatike. **Kategoria e parë** është Teuhidi Rububijeh, që është: njësimi i Allahut në veprat e Tij, i Përsosur është Ai nga çdo e metë. Dhe ai është që të besosh se Allahu është Krijuesi, Furnizuesi, Sistemuesi i çështjeve të krijesave, Drejtuesi i punëve të tyre në këtë botë dhe në Botën Tjetër, i pa ortakë në këtë, sikurse ka thënë i Lartësuar: “Allahu ka krijuar gjithçka.” [ez-Zumer, 62] Dhe ka thënë i Lartësuar: “Zoti juaj është Allahu, Ai i Cili krijoi qiejt dhe tokën në gjashtë ditë e pastaj u ngrit mbi Arsh, duke drejtuar gjithçka.” [Junus, 3] Dhe këtë kategori të Teuhidit e pohuan Mushrikët, adhuruesit e idhujve, ndonëse shumica e tyre mohuan ringjalljen dhe tubimin (Ditën e Kijametit), dhe ky pohim i Teuhidit Rububijeh nuk i futi ata në Islam për shkak se ata i bëni Shirk Allahut në adhurim dhe adhuronin idhujt, njerëzit, xhinët dhe melaiket krahas Allahut të Përsosur nga çdo e metë dhe se ata nuk e besuan të Dërguarin, Muhamedin (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*). **Kategoria e dytë** është Teuhidi i Ibadetit, i cili quhet ndryshe Teuhidi Uluhijeh, që është adhurimi. Dhe kjo është ajo kategori e Teuhidit të cilën e refuzuan Mushrikët, për të cilët Allahu i Përsosur nga çdo e metë ka thënë për ta me Fjalën e Tij: “Ata u çuditën për ardhjen e një paralajmëruesi nga gjiri i tyre dhe mosbesimtarët thanë: “Ky është magjistar dhe gënjeshtar. A mos kërkon ai, që të gjithë të adhuruarit t’i bëjë një të Adhurar të Vetëm? Me të vërtetë që kjo është një gjë shumë e çuditshme!”” [Sa’d, 4-5] Dhe shembuj të tillë ka shumë. Dhe kjo kategori e Teuhidit përfshin dedikimin e adhurimit me sinqeritet për Allahun të vetëm dhe të besuarit se vetëm Ai e meriton atë dhe se adhurimi për dikë tjetër pos Tij është i kotë (batil). Dhe ky është kuptimi i fjalës “La ilahe il-lAllah”, ngase kuptimi i saj është: s’ka të adhurar tjetër me të drejtë përveç Allahut, sikurse ka thënë Allahu Krenar e Madhështor: “Kjo sepse Allahu është i Adhuruari me të drejtë, kurse ajo që ata adhurojnë në vend të Tij është e kotë.” [el-Haxh, 62] **Kategoria e tretë** është Teuhidi el-Esma` ues-Sifat, që është: të besosh çdo Emër e çdo Cilësi të Allahut që ka ardhur në Librin Madhështor të Allahut dhe në Sunetin e Saktë nga i Dërguari i Allahut (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*), t’i pohosh ato për Allahun e

إِنَّ اللَّهَ وَاحِدٌ لَا شَرِيكَ لَهُ

❖ Me të vërtetë Allahu është Një e s'ka ortak.

وَلَا شَيْءٌ مِثْلُهُ

❖ S'ka gjë të ngjashme me Të.

---

Përsosur nga çdo e metë ashtu siç i ka hije Allahut, pa i deformuar, pa i mohuar, pa hetuar detajet e tyre dhe pa i shembëlluar/ngjasuar, sikurse ka thënë Allahu i Përsosur nga çdo e metë: “Thuaj: **“Thuaj: Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm! Allahu është Ai të Cilit i përgjërohet gjithçka në amshim. Ai as nuk lind, as nuk është i lindur. Dhe askush nuk është i barabartë (a i krahasueshëm) me Atë!”** [el-Ikhlâs, 1-4] Dhe ka thënë i Përsosuri nga çdo e metë: “**Asgjë nuk është si Ai dhe Ai është Gjithëdëgjuesi dhe Gjithëshikuesi.**” [esh-Shuura, 11] Dhe ka thënë Krenari e i Madhërishmi: “**E të Allahut janë Emrat e Bukur prandaj lutjuni Atij me ato.**” [el-E’araf, 180] Dhe ka thënë i Përsosuri nga çdo e metë në suren en-Nahl: “**Allahut i përket shembulli më i lartë (cilësitë më të larta); Ai është i Plotfuqishmi, më i Urti.**” [en-Nahl, 60] Ajetet me këtë kuptim janë të shumta. Dhe “**shembulli më i lartë**” është cilësimi i lartë i cili s’ka asnjë të metë e magësi, dhe kjo është fjala e Ehli-Sunetit dhe Xhematit, e Sahabëve të të Dërguarit (*sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem*) dhe e atyre që i pasuan me mirësi. Ata i lënë ajetet dhe hadithet që flasin për Cilësitë e Allahut ashtu siç kanë ardhur dhe i pohojnë kuptimet e tyre për Allahun e Përsosur nga çdo e metë, i pohojnë pa i përngjasuar dhe e pastrojnë Allahun nga shembëllimi me krijesat e Tij, e pastrojnë Atë nga shembëllimi pa i mohuar Cilësitë e Tij. Dhe për këtë që thonë dëshmojnë kategorikisht të gjitha argumentet e Kur’anit dhe Sunetit dhe ngrihet argumenti kundër atyre që i kundërshtojnë. Dhe pikërisht ata janë të cilët i ka përmendur i Përsosuri nga çdo e metë në Fjalën e Tij: “**Sa u përket besimtarëve të parë, Muhaxhirëve dhe Ensarëve dhe atyre që i pasuan ata me mirësi, Allahu është i kënaqur me ata dhe ata janë të kënaqur me Atë. Allahu ka përgatitur për ata kopshte nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe ku do të jetojnë përgjithmonë. Kjo është fitorja madhështore!**” [et-Teubeh, 100] Na bëftë Allahu me mirësinë dhe bujarinë e tij prej tyre! Dhe Allahut i kërkojmë ndihmë.

وَلَا شَيْءٌ يُعْجِزُهُ

❖ Asgjë nuk është e pamundur për Të;

وَلَا إِلَهَ غَيْرُهُ

❖ S'ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Tij.

قَدِيمٌ بِلَا اِبْتِدَاءٍ، دَائِمٌ بِلَا اِنْتِهَاءٍ

❖ I Vjetër<sup>2</sup> pa fillim; i Përjetshëm pa mbarim.

لَا يَفْنَى وَلَا يَبِيدُ

❖ Nuk zhduket dhe nuk shuhet.

---

<sup>2</sup> [Komentoi Shejkh 'Abdul-'Aziz Ibën Baz \(rahimehullah\) duke thënë:](#)

Ky emër nuk është përmendur mes Emrave të Bukur të Allahut, sikurse ka bërë të ditur shpjeguesi (Ibën Ebil-'Izz el-Hanefij), Allahu pastë mëshirë për të, si dhe të tjerë veç tij. Në të vërtetë ky emër është përmendur nga dijetarët e filozofisë për të vëretuar me të egzistencën e Tij para çdo gjëje tjetër. Porse Emrat e Allahut janë *teukifije* (të kufizuara vetëm në Kur'an dhe në Hadithet e sakta). Nuk lejohet të pohosh ndonjë prej tyre pa patur tekst të qartë nga Kur'ani Fisnik apo nga Suneti Autentik dhe as nuk lejohet të pohosh ndonjë prej tyre duke u bazuar në mendime, sikurse kanë thënë Imamët e Selefëve të Mirë. Dhe fjala “*kadijm* - i vjetër” nuk tregon kuptimin që kanë dashur dijetarët e filozofisë, ngase kjo fjalë në gjuhën Arabe nënkupton atë që ka paraprirë të tjerët, edhe nëqoftëse ai është paraprirë nga mos-egzistenca, siç ka ardhur në Fjalën e të Përsosurit nga çdo e metë: “...**derisa të kthehet si një kërcell i vjetër hurme.**” [Ja-Siin, 39] Por kjo fjalë tregon kuptimin e vërtetë me shtesën që ka përmendur autori, që është thënia e tij “I Vjetër pa fillim”, porse kjo nuk duhet të llogaritet si një nga Emrat e Bukur të Allahut për shkak të mos-vërtetimit të tij në transmetimet që kanë ardhur; mjafton emri i të Përsosurit nga çdo e metë “*el-Euelu* - i Pari”, sikurse ka thënë i Lavdishmi e i Lartmadhëri: “**Ai është i Pari (*el-Euelu*) dhe i Fundit (*el-Akhiru*).**” [el-Hadijd, 3] Dhe Allahu është Dhënësi i Suksesit.

وَلَا يَكُونُ إِلَّا مَا يُرِيدُ

❖ Asgjë nuk ndodh e nuk vjen në egzistencë, përveçse çfarë do Ai.

لَا تَبْلُغُهُ الْأَوْهَامُ

❖ Fantazitë dhe imagjinata s'mund ta perceptojnë Atë.

وَلَا تُدْرِكُهُ الْأَفْهَامُ

❖ As botëkuptimet s'mund ta arrijnë Atë.

وَلَا يُشْبِهُهُ الْأَنَامُ

❖ Asnjë nga krijesat nuk është si Ai.

حَيٌّ لَا يَمُوتُ

❖ I Gjallë që s'vdes kurrë.

قَيُّومٌ

❖ I Panevojshëm për askënd, ndërsa gjithçka ka nevojë për Të.

لَا يَنَامُ

❖ Ai nuk fle kurrë.

خَالِقٌ بِلَا حَاجَةٍ

❖ Krijon pa patur nevojë për krijesat e Tij.

رَازِقٌ بِلَا مَوْئِنَةٍ

❖ Furnizon pa kurrëfarë mundimi.

مُمِيتٌ بِلَا مَخَافَةٍ

❖ Jep vdekjen pa kurrëfarë druajtjeje.

بَاعِثٌ بِلَا مَشَقَّةٍ

❖ Ringjall pa kurrëfarë vështirësie.

مَا زَالَ بِصِفَاتِهِ قَدِيمًا قَبْلَ خَلْقِهِ

❖ Ai ka qenë gjithmonë me Cilësitë e Tij para krijimit të krijesave të Tij.

لَمْ يَزِدْ بِكُونِهِمْ شَيْئًا لَمْ يَكُنْ قَبْلَهُمْ مِنْ صِفَتِهِ

❖ Me krijimin e krijesave Atij nuk iu shtua asnjë Cilësi, që të mos e ketë patur më parë.

وَكَمَا كَانَ بِصِفَاتِهِ أَزَلِيًّا، كَذَلِكَ لَا يَزَالُ عَلَيْهَا أَبَدِيًّا

❖ Dhe siç ka qenë gjithmonë me Cilësitë e Tij, ashtu vazhdon të jetë me ato Cilësi në përjetësi.

لَيْسَ بَعْدَ خَلْقِ الْخَلْقِ اسْتِفَادَ اسْمَ "الْخَالِقِ"

❖ Nuk është se Ai e fitoi emrin “*el-Khaalik* –Krijuesi” pasiqë krijoi krijesat.



وَلَا بِإِحْدَائِهِ الْبَرِّيَّةِ اسْتَفَادَ اسْمَ "الْبَارِي"

❖ Dhe as nuk e fitoi emrin “*el-Baarij* – Shpikësi” pasi që shpiku gjallesat.

لَهُ مَعْنَى الرَّبُّوبِيَّةِ وَلَا مَرْبُوبَ

❖ Ai ka qenë Sunduesi (*er-Rrabb*) edhe kur nuk ka patur genie ekzistuese nën Sundimin e Tij.

وَمَعْنَى الْخَالِقِ وَلَا مَخْلُوقَ

❖ Dhe Ai ka qenë Krijuesi edhe kur nuk ka patur krijesa në egzistencë.

وَكَمَا أَنَّهُ مُدْهِبِي الْمَوْتَى بَعْدَمَا أَحْيَا، اسْتَحَقَّ هَذَا الْاسْمَ قَبْلَ إِحْيَائِهِمْ

❖ Sikurse Ai është Ngjallësi i të vdekurve pasiqë u dha jetë atyre, po ashtu Ai e meriton këtë emër qysh para se t'i sillte në jetë ata.

كَذَلِكَ اسْتَحَقَّ اسْمَ الْخَالِقِ قَبْلَ إِنْشَائِهِمْ

❖ Gjithashtu, Ai e meriton emrin Krijues qysh përpara se t'i krijonte krijesat.

ذَلِكَ بِأَنَّهُ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ

❖ Sepse Ai është i Plotëfuqishëm për gjithçka.

وَكُلُّ شَيْءٍ إِلَيْهِ قَوِيرٌ

❖ Dhe çdo gjë ka nevojë për Atë.

وَكُلُّ أَمْرٍ عَلَيْهِ يَسِيرٌ

❖ Dhe gjithçka për Ætë është e lehtë.

لا يَحْتَأْجُ إِلَى شَيْءٍ، {أَيْسَ كَمَثَلِهِ شَيْءٌ وَهُوَ السَّمِيعُ الْبَصِيرُ}

❖ Æi s'ka nevojë për asgjë, "Asgjë nuk është e ngjashme me Të dhe Æi është Gjithëdëgjuesi dhe Gjithëshikuesi." [ Esh-Shuura, 11]

خَلَقَ الْخَلْقَ بِعِلْمِهِ

❖ Æi i krijoi krijesat me Dijen e Tij.

وَقَدَّرَ لَهُمْ أَقْدَارًا

❖ Dhe Æi caktoi fatet e tyre.

وَضَرَبَ لَهُمْ أَجَالَآ

❖ Dhe gjithkujt Æi i dha exhelin (fundin) e tij.

وَلَمْ يَخَفْ عَلَيْهِ شَيْءٌ قَبْلَ أَنْ يَخْلُقَهُمْ

❖ Asgjë nuk ka qenë e panjohur për Të në lidhje me krijesat e tij para se t'i krijonte ato.

وَعَلِمَ مَا هُمْ عَامِلُونَ قَبْلَ أَنْ يَخْلُقَهُمْ

❖ Dhe Æi e dinte çfarë do të punonin përpara se t'i krijonte ato.

وَأَمَرَهُمْ بِطَاعَتِهِ وَنَهَاهُمْ عَنْ مَعْصِيَتِهِ

❖ Æi i ka urdhëruar ata që t'i binden Ætij dhe i ka ndaluar nga mosbindja ndaj Tij.

وكلُّ شَيْءٍ يَجْرِي بِتَقْدِيرِهِ، وَمَشِيئَتِهِ

❖ Çdo gjë ndodh me Caktimin e Tij dhe me Dëshirën e Tij.

وَمَشِيئَتُهُ تَنْفُذُ لَا مَشِيئَةَ لِلْعِبَادِ إِلَّا مَا شَاءَ لَهُمْ، فَمَا شَاءَ لَهُمْ كَانَ، وَمَا لَمْ يَشَأْ لَمْ يَكُنْ

❖ Ndodh vetëm ajo që dëshiron Ai dhe jo ajo që dëshirojnë robërit, përveç asaj që do Ai për ta; dhe ajo që do Ai për ta ndodh, kurse ajo që nuk e do nuk ndodh.

يَهْدِي مَنْ يَشَاءُ، وَيَعْصِمُ وَيُعَافِي فَضْلًا، وَيُضِلُّ مَنْ يَشَاءُ، وَيَخْذُلُ وَيَبْتَلِي عَدْلًا

❖ Ai udhëzon kë të dojë dhe mbron e shëron me mirësinë e Tij; humb kë të dojë dhe braktis e jep fatkeqësi me drejtësinë e Tij.

وَكُلُّهُمْ يَتَقَلَّبُونَ فِي مَشِيئَتِهِ بَيْنَ فَضْلِهِ وَعَدْلِهِ

❖ Të gjithë i nënshtrohen Dëshirës së Tij, midis mirësisë dhe drejtësisë së Tij.

وَهُوَ مُتَعَالٍ عَنِ الْأَضْدَادِ وَالْأَنْدَادِ

❖ I Cartësuar është Ai nga të paturit rivalë apo të barabartë.

لَا رَادَّ لِقَضَائِهِ، وَلَا مَعْقَبَ لِحُكْمِهِ، وَلَا غَالِبَ لِأَمْرِهِ

❖ Askush nuk mund të refuzojë Caktimin e Tij, apo të vonojë përmbushjen e Gjykimit të Tij apo të anulojë Urdhërin e Tij.

ءَامِنًا بِذَلِكَ كُلِّهِ، وَأَيَقِنًا أَنَّ كُلًّا مِنْ عِنْدِهِ

❖ Ne i besojmë të gjitha këto dhe jemi të bindur që çdo gjë vjen prej Tij.

وَأَنَّ مُحَمَّدًا صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ عَبْدُهُ الْمُصْطَفَى، وَنَبِيُّهُ الْمَجْتَبَى، وَرَسُولُهُ الْمُرْتَضَى

❖ Dhe Muhamedi është rob i Tij i Zgjedhur, Profeti i Tij i dalluar mbi të gjithë të tjerët, i Dërguari i Tij me të cilin Ai është i Kënaqur.

وَإِنَّهُ خَاتَمُ الْأَنْبِيَاءِ، وَإِمَامُ الْأَتْقِيَاءِ، وَسَيِّدُ الْمُرْسَلِينَ، وَحَبِيبُ رَبِّ الْعَالَمِينَ

❖ Ai është Vula e Profetëve, imami i të devotshmëve, zotëria i të Dërguarve dhe i dashuri i Zotit të Gjithësisë.

وَكَلُّ دَعْوَةٍ نُبُوَّةٍ بَعْدَ نُبُوَّتِهِ فَغَيٌّ وَهُوَ

❖ Dhe çdo pretendim për pejgamberi mbas pejgamberllëkut të tij është lajthitje dhe hava.

وَهُوَ الْمَبْعُوثُ إِلَى عَامَةِ الْجَنِّ وَكَافَةِ الْوَرَى بِالْحَقِّ وَالْهُدَى وَالنُّورِ وَالضِّيَاءِ

❖ Ai është i dërguar për të gjithë Xhinët dhe për të gjithë njerëzimin me të Vërtetën dhe Udhëzimin, me Dritë dhe Ndriçim.

وَإِنَّ الْقُرْآنَ كَلَامُ اللَّهِ، مِنْهُ بَدَأَ بِهَا كَيْفِيَّةً قَوْلًا، وَأَنْزَلَهُ عَلَى رَسُولِهِ وَحِيًّا، وَصَدَّقَهُ الْمُؤْمِنُونَ عَلَى ذَلِكَ حَقًّا، وَأَيَقِنُوا أَنَّهُ كَلَامُ اللَّهِ تَعَالَى بِالْحَقِيقَةِ

❖ Kur'ani është Fjala e Allahut, ka ardhur nga e folura e Tij dhe mënyra e saj nuk dihet; Ai ia zbriti të Dërguarit të Tij si shpallje dhe besimtarët e pranojnë atë të vërtetë dhe janë të bindur që ai është Fjala e vërtetë e Allahut të Cartësuar.

ليس بمخلوق ككلام البريئة، فمن سمعه فزعم أنه كلام البشر فقد كفر، وقد ذمَّ الله وعابه وأوعده بسقر حيث قال تعالى: {سأصليه سقر}، فلما أوعدَّ الله بسقر لمن قال: {إن هذا قول البشر}، علمنا وأيقنا أنه قولُ خالق البشر، ولا يُشبهه قولَ البشر

❖ **Āi** (Kur'ani) nuk është i krijuar sikurse fjalët e krijesave, andaj kush e dëgjon atë dhe pastaj pretendon se ai është fjalë e njeriut, ka bërë kufër (ka mohuar); atë e ka qortuar dhe dënuar ashpër Allahu dhe i ka premtuar atij Zjarrin. Ka thënë i Cartësuari: “Atë do ta djeg në Zjarr.” [El-Mudeth-thir, 26] Dhe përderisa Allahu i ka premtuar Zjarrin atij që thotë: “S’ka dyshim se ky s’është gjë tjetër përveç se fjalë e njeriut.” [El-Mudeth-thir, 25] – atëherë, nga kjo mësojmë dhe bindemi se me të vërtetë Kur’ani është Fjala e Krijuesit të njeriut dhe se Fjala e Tij nuk është e ngjashme me fjalën e njeriut.

ومن وصف الله بمعنى من معاني البشر فقد كفر

❖ Dhe kush e cilëson Allahun me ndonjë aspekt nga aspektet njerëzore ka bërë kufër.

فمن أبصرَ هذا اعتبر، وعن مثل قول الكفار انزجر، وعلم أنه بصفاته ليس كالنفس

❖ Kush e kupton këtë merr mësim dhe qëndron larg këtyre fjalëve të qafirave, si dhe do të mësojë se Āi me Cilësitë e Tij nuk është si njeriu.

والرؤية حق لأهل الجنة، بغير إحاطة ولا كيفية، كما نطق به كتاب ربنا: {وَجِوهٌ يَوْمَئِذٍ نَاضِرَةٌ \* إِلَى رَبِّهَا نَاظِرَةٌ}، وتفسيره على ما أَرَادَهُ اللهُ تَعَالَى وَعَلِمَهُ، وَكُلُّ مَا جَاءَ فِي ذَلِكَ مِنَ الْحَدِيثِ الصَّحِيحِ عَنِ الرَّسُولِ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ فَهُوَ كَمَا قَالَ وَمَعْنَاهُ عَلَى مَا أَرَادَ

❖ Shikimi i Allahut nga banorët e Xhenetit është i vërtetë. Shikimi i tyre nuk do të jetë gjithëpërfshirës dhe është e paditur se si mund të jetë Āi, sikurse ka thënë Libri i Zotit

tonë: “Atë ditë, disa fytyra do të shkëlqejnë; dhe Zotin e tyre do të shohin.” [el-Kijameh, 22-23] Dhe shpjegimi i kësaj është ashtu siç do dhe e di Allahu i Cartësuar. Dhe çdo gjë që ka ardhur për këtë në hadith të saktë (*sahih*) nga i Dërguari (*sal-l'Allahu 'alejhi ue sel-lem*) është ashtu siç ka thënë ai dhe me atë kuptim që ka dashur ai.

لا ندخلُ في ذلك متأولينَ بأرائنا ولا متوهِّمينَ بأهوائنا

❖ Ne nuk hyjmë në hetimin e mënyrës së shikimit duke e interpretuar atë me mendimet tona e as duke fantazuar me epshet tona.

فإنَّه ما سلِّم في دينه إلا من سلِّم لله عزَّ وجلَّ ولرسوله صلى الله عليه وسلم وردَّ  
علمَ ما اشتَبه عليه إلى عالمه

❖ Se me të vërtetë, nuk shpëton në fenë e tij, përveç se ai që iu nënshtrua Allahut 'Azze ue Xhel-le dhe të Dërguarit të Tij (*sal-l'Allahu 'alejhi ue sel-lem*) dhe e kthen dijen e asaj që e ka të paqartë tek ai që e di atë.

ولا تثبتُ قدَّمَ في الإسلام إلا على ظهر التسليم والاستسلام

❖ Dhe nuk vërtetohet Islami përveç se me nënshtrim dhe dorëzim.

فمن رامَ علمَ ما حُظِر عنه علمُه، ولم يقنع بالتسليم فهمُه، حجبه مرأه عن  
خالص التوحيد، وصافي المعرفة، وصحيح الإيمان، فيتذبذبُ بين الكفر  
والإيمان والتصديق والتكذيب، والإقرار والإنكار، موسوسًا تائهاً شاكًا، لا  
مؤمنًا مصدقًا، ولا جاهدًا مكذبًا

❖ Dhe kush dëshiron të dijë diturinë nga e cila ai është ndaluar dhe nuk kënaqet me nënshtrimin e botëkuptimit të tij,

atëherë dëshira e tij do ta pengojë atë nga Teuhidi i Pastër dhe Dija e Kulluar dhe Imani i Saktë, si dhe do të lëkundet ndërmjet Kufrit dhe Imanit, ndërmjet Vërtetimit dhe Përgënjeshtimit, ndërmjet Pohimit dhe Mohimit, i kapluar nga vesveset, i çoroditur e plot dyshime, as besimtar që pohon e as mohues që përgënjeshton.

ولا يصحُ الإيمانُ بالرؤيةِ لأهل دار السلام لمن اعتبرَها منهم بوهْمٍ أو تأوَّلها بفهمٍ إذ كانَ تأويلُ الرؤيةِ وتأويلُ كلِّ معنى يضافُ إلى الربوبيةِ بتركِ التأويلِ ولزومِ التسليمِ، وعليه دينُ المسلمينَ

❖ Dhe nuk është i saktë besimi në Shikimin e Allahut nga Banorët e Tokës së Paqes (Xhenetit) për ata që mundohen ta fantazojnë apo ta shpjegojnë atë me botëkuptimin e tyre, pasi shpjegimi i Shikimit në Allahun dhe shpjegimi i çdo kuptimi të Rububijes është që të lihet interpretimi dhe t'i përmbahesh nënshtrimit. Dhe mbi këtë ngrihet Feja e Muslimanëve.

ومن لم يتوقَّ النفيَ والتشبيهُ زلَّ ولم يصبِ التنزيهَ

❖ Dhe kush nuk i shmanget mohimit dhe përngjasimit (të Cilësive të Allahut) ka rrëshqitur dhe nuk ka arritur që të dëshmojë për pastërtinë (e Allahut nga çdo e metë).

فإنَّ ربَّنَا جَلٌّ وِعَلا موصوفٌ بصفاتِ الوحدانيةِ، منعوتٌ بِنُعوتِ الفردانيةِ، ليس في معناه أحدٌ من البريةِ

❖ Se me të vërtetë Zoti ynë Madhështor e i Shtëruar është Unik me Qenien e Tij dhe Cilësitë e Tij nuk i ka askush tjetër pos Tij dhe asnjë nga krijesat nuk është si Ai.



وتعالى عن الحدود والغايات والأركان والأعضاء والأدوات، لا تحويه الجهات الست كسائر المبتدعات

❖ Dhe Shumë i Lartë është Ai nga të paturit kufij, qëllime, pjesë, gjymtyrë dhe organe. Ai nuk përfshihet në gjashtë drejtimet ashtu si krijesat.<sup>3</sup>

<sup>3</sup> **Komentoi Shejkh ‘Abdul-‘Aziz Ibën Baz (*rahimehullah*) duke thënë:**

Fjala e tij: “Dhe i Lartësuar është Ai nga të paturit kufij, qëllime, pjesë, gjymtyrë dhe organe. Ai nuk përfshihet në gjashtë drejtimet ashtu si krijesat.” – Kjo fjalë përmban përgjithësim të cilin mund ta shfrytëzojnë njerëzit e deformimit dhe mohimit të Emrave të Allahut dhe Cilësive të Tij, edhe pse aty nuk ka kurrëfarë argumenti për ata, ngase qëllimi i tij – Allahu e mëshiroftë – është që ta pastrojë Krijuesin e Përsosur nga çdo përngjasimi me krijesat. Porse ai erdhi me fjalë të përgjithshme që kanë nevojë për shtjellim në mënyrë që të largohet pështjellimi. Dhe qëllimi i tij me: “kufij” – domethënë ato kufij që njeh njerëzimi, ngase kufijtë e të Përsosurit nga çdo e metë nuk i njeh askush tjetër pos të Përsosurit nga çdo e metë, sepse krijesat nuk mund ta përfshijnë Atë me dijen e tyre, sikurse ka thënë Krenari e Madhështori në suren Ta-Ha: “Ai e di ç’ka para tyre dhe ç’ka pas tyre, kurse ata nuk mund ta ngërthejnë dijeninë e Allahut.” [Ta-Ha, 110] E nëse dikush prej Selefëve e ka pohuar “kufirin” në Istiuanë [ngritjen e Allahut mbi Arshin e Tij] apo në ndonjë aspekt tjetër, ai ka patur për qëllim kufirin të cilin e di vetëm Allahu Subhanehu ue Te’ala dhe nuk e dinë robërit. Kurse qëllimi i tij – Allahu e mëshiroftë – me fjalët “qëllime, pjesë, gjymtyrë dhe organe” është që pohojë se Allahu është i pastër nga ngjasimi me krijesat në Urtësinë e Tij, në Cilësitë e Qenies së Tij, siç është Fytyra, Dora, Këmba etj., se Ai, i Përsosuri nga çdo e metë, i ka ato Cilësi, por ama Cilësitë e Tij nuk janë sikur cilësitë e krijesave dhe as nuk e di kush se si janë ato përveç se Allahu i Përsosur nga çdo e metë. Kurse njerëzit e bidatit i përdorin termat si këto me qëllim që nëpërmjet tyre të mohojnë Cilësitë të cilat i ka përmendur Allahu dhe i ka vërtetuar për Vetën e Tij, në mënyrë që ata të mos demaskohen dhe të mos poshtërohen nga pasuesit e të vërtetës. Dhe autori – et-Tahauij *rahimehullah* - nuk ka këtë për qëllim sepse ai është prej Ehli-Sunetit, prej atyre që i pohojnë Cilësitë e Allahut, dhe fjalët e tij tek kjo akijde sqarojnë njëra-tjetrën dhe vërtetojnë njëra-tjetrën dhe qartësojnë të paqartat me fjalët e tij të qarta. E njëjta gjë është edhe me fjalën e tij, “Ai nuk përfshihet në gjashtë drejtimet ashtu si krijesat.”



والمعراجُ حقٌّ، وقد أسري بالنبِيِّ صَلَّى اللهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ وعُرِجَ بشخصه في اليَقْظَةِ إلى السماءِ ثُمَّ إلى حيثُ شاءَ اللهُ من العُلَى، وأكْرَمَهُ اللهُ بما شاءَ، وأوحى إليه ما أوحى، {ما كَذَبَ الْفُؤَادُ مَا رَأَى}، فصلى اللهُ عليه وسلمَ في الآخِرَةِ والأوْلَى

❖ Dhe se Miraxhi është i vërtetë. Pejgamberi (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*) u mor natën dhe u ngjit në qiell me trupin e tij, duke qenë i zgjuar (e jo në gjumë), dhe pastaj u ngjit në atë lartësi që deshi Allahu. Allahu e nderoi atë me çka deshi Ai dhe i shpalli atij atë çka i shpalli: “Zemra (e Muhamedit) nuk gënjen për atë që ka parë.” [en-Nexhm, 11] E, mbi të qoftë lavdërimi dhe bekimi i Allahut në dynja e në Ahiret.

والحوضُ الذي أكرمه اللهُ تعالى بهِ غيائًا لأُمَّتهِ حقٌّ

❖ Haudi me të cilin Allahu i Lartësuar nderoi Pejgamberin dhe me të do të largojë etjen e Umetit të tij është i vërtetë.

والشفاعةُ التي ادَّخرها لهم حقٌّ، كما رُوي في الأخبار

❖ Ndërmjetësimi (*esh-Shefa'ah*) që Ai e ka rezervuar për ta është i vërtetë, sikurse ka ardhur në transmetime.

---

Ai ka për qëllim gjashtë drejtimet e krijuara, e nuk ka për qëllim mohimin e Lartësimit dhe Ngritjes së Allahut mbi Arshin e Tij, ngase kjo nuk futet tek gjashtë drejtimet, porse Ai është përmbi Gjithësinë dhe Mbikqyrës mbi të. Dhe me të vërtetë Allahu i ka krijuar robërit e Tij me fitrën (natyrshmërinë, instiktin) e besimit në Lartësimin e Allahut të Përsosur nga çdo e metë dhe se Ai është në kahun lartë. Dhe për këtë kanë rënë në ixhma (unanimitet) Ehli-Suneti dhe Xhemati, që nga Sahabët e Pejgamberit (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*) e deri tek ata që e pasuan rrugën e tyre me mirësi. Dhe argumentet nga Kur'ani dhe Suneti i Saktë janë të shumta fare, që të gjitha tregojnë se i Përsosuri nga çdo e metë është Lartë. Kështu që, ki mendjen tek kjo çështje madhështore o ti lexues i nderuar, dhe dije se kjo është e vërteta dhe çdo gjë tjetër pos saj është *batil* (e pavërtetë). Dhe sukcesi vjen vetëm prej Allahut.

والميثاق الذي أخذَه اللهُ تعالى من آدمَ وذريتهِ حقٌ

❖ Besa (el-Mijthak) të cilën Allahu e ka marrë nga bijtë e Ademit dhe pasardhësit e tij është e vërtetë.

وقد علمَ اللهُ تعالى فيما لم يزلَ عددٌ من يدخلُ الجنةَ وعددٌ من يدخلُ النارَ جملةً واحدةً، فلا يُزادُ في ذلكَ العددِ ولا يُنقصُ منه

❖ Allahu i Cartësuar e ka ditur gjithmonë numrin e njerëzve që do të hyjnë në Xhenet dhe numrin e atyre që do të hyjnë në Zjarr, të gjithë papëryshim; dhe as nuk shtohet ai numër e as nuk pakësohet.

وكذلكَ أفعالهم فيما علمَ منهم أن يفعلوه

❖ E njëjta gjë edhe me veprat e tyre; Ai e ka ditur gjithmonë çfarë do të bënin ata.

وكلُّ ميسرٍ لِمَا خُلِقَ له

❖ Dhe çdo njeriu i lehtësohet ajo për të cilën u krijua.

والأعمالُ بالخواتيم

❖ Dhe veprat janë sipas përfundimeve të tyre.

والسعيدُ من سعدَ بقضاءِ اللهُ تعالى، والشقيُّ من شقيَّ بقضاءِ اللهُ

❖ I lumtur është ai që u lumturua me Caktimin e Allahut dhe i mjeruar është ai që u mjerua me Caktimin e Allahut.

وأصلُ القدرِ سرُّ اللهُ تعالى في خلقه، لم يطلعْ على ذلكَ ملكٌ مقربٌ ولا نبيُّ مرسلٌ

❖ Kaderi është sekret i Allahut të Cartësuar në krijimin e Tij, nuk arrin njohjen e tij as ndonjë melek i afërt tek Allahu dhe as ndonjë peygamber i dërguar.

والتعمق والنظر في ذلك ذريعة الخذلان وسئلم الحرمان ودرجة الطغيان

❖ Thellimi dhe hulumtimi në çështjen e Kaderit është rrugë që të shpie drejt dështimit, privimit dhe kalimit të kufirit.

فالحذر كلَّ الحذر من ذلك نظراً وفكراً ووسوسة، فإنَّ الله تعالى طوى علمَ القدر  
عن أناميه ونهاهم عن مراميه كما قالَ تعالى في كتابه:  
{ لا يسئل عما يفعل وهم يسئلون }

❖ Prandaj ki kujdes, ruhu nga shikimi, meditimi dhe çytjet në çështjen e Kaderit, ngase Allahu i Shtësuar e ka mbajtur të fshehur nga krijesat diturinë e Kaderit dhe i ndaloi ata që ta hulumtojnë atë. Sikurse ka thënë i Shtësuari: “**Ai nuk mund të pyetet për atë që bën, kurse ata do të pyeten.**” [el-Enbija, 23]

فمن سأل: لم فعل؟ فقد ردَّ حكمَ الكتاب، ومن ردَّ حكمَ الكتاب كان من الكافرين

❖ Dhe ai që pyet: “Përse e bëri?”, ka refuzuar gjykimin e Kur’anit. Dhe kush refuzon gjykimin e Kur’anit bëhet mosbesimtar.

فهذه جملة ما يحتاج إليه من هو منور قلبه من أولياء الله تعالى، وهي درجة  
الراسخين في العلم

❖ Kjo është përmbledhje e çështjeve (rreth Kaderit) që i nevojiten atij e ka zemrën të ndriçuar dhe është prej eulijave të Allahut të Shtësuar. Dhe kjo është grada e atyre që janë të rrënjosur në dije.

لأنَّ العلمَ علمان: علمٌ في الخلق موجودٌ، وعلمٌ في الخلق مفقودٌ، فإنكارُ العلمِ  
الموجودِ كفرٌ، وادعاءُ العلمِ المفقودِ كفرٌ

❖ Sepse dituria është dy llojëshe: dija që është e pranishme tek krijesat, dhe dija që është e fshehur nga krijesat.<sup>4</sup> Kështu që, refuzimi i dijes së pranishme është kufër, dhe pretendimi i posedimit të dijes së fshehur është kufër.

ولا يثبتُ الإيمانُ إلا بقبول العلم الموجود، وترك طلب العلم المفقود

❖ Dhe nuk vërtetohet Imani përveç se me pranimin e dijes së pranishme dhe lënien e kërkimit të dijes së fshehtë.

ونؤمنُ باللوح والقلم وبجميع ما فيه قد رُقمَ

---

<sup>4</sup> [Komentoi Shejkh ‘Abdul-‘Aziz Ibën Baz \(rahimehullah\) duke thënë:](#)

Qëllimi i tij - Allahu pastë mëshirë për të - me “dijen e fshehur” është dija e Gajbit, e cila është e veçantë për Allahun (‘Azze ue Xhel-le) dhe ai njeri që pretendon se e posedon atë dije ka bërë kufër (ka mohuar), për shkak se Allahu i Përsosur nga çdo e metë ka thënë: “Tek Ai janë Çelësat e të Fshehtës dhe vetëm Ai i di ato.” [el-En’am, 59] Dhe thotë Allahu (‘Azze ue Xhel-le): “Thuaj: askush nuk e di të fshehtat në qiej e në tokë, përveç Allahut.” [en-Neml, 65] Dhe nga fjala e Pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sellem): “Çelësat e Gajbit janë pesë dhe askush nuk i di ato, përveç Allahut.” Pastaj ai recitoi Fjalën e Allahut të Përsosur nga çdo e metë: “Pa dyshim, vetëm Allahu e di Orën e caktuar dhe Ai e zbret shiun...” [Lukman, 34] Dhe hadithet e sakta e të shumta të cilat kanë ardhur për këtë temë tregojnë se Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sellem) nuk e di Gajbin, ndonëse ai është krijesa më e mirë dhe zotëria i të Dërguarve, e sa e mundur është njohja e Gajbit nga ata që janë poshtë tij? Ai (sal-lAllahu ‘alejhi ue sellem) nuk di gjë nga Gajbi, me përjashtim të asaj që ia mësoi Allahu i Përsosur nga çdo e metë. Dhe kur njerëzit e shpifjes folën kundër A’ishes (radij-Allahu ‘anha), ai nuk e dinte pafajësinë e saj përveçse kur zbriti shpallja. Dhe kur asaj i humbi varësja kur në disa prej udhëtimeve të tij (sal-lAllahu ‘alejhi ue sellem), ai dërgoi disa njerëz që ta kërkonin varësen dhe ai nuk e dinte vendin ku ndodhej varësja, derisa kur e çuan devenë dhe e gjetën poshtë saj. Argumentet nga Kur’ani dhe Suneti që tregojnë se Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sellem) nuk e dinte Gajbin janë të shumta, lavdi Allahut.

❖ Ne besojmë në Pllakën e Ruajtur (*el-Şeuhul-Mahfuudh*) dhe Penën dhe çka është shkruajtur në të.

فلو اجتمع الخلقُ كلُّهم على شيءٍ كتبه اللهُ تعالى فيه أنه كائنٌ ليجعلوه غيرَ كائنٍ لم يقدرُوا عليه

❖ Ë nëse mblidhen të gjitha krijesat për të ndaluar diçka që Allahu e ka shkruajtur për të ndodhur, ata nuk do të arrijnë ta ndalojnë dot.

ولو اجتمعوا كلُّهم على شيءٍ لم يكتبه اللهُ تعالى فيه ليجعلوه كائنًا لم يقدرُوا عليه

❖ Ë nëse mblidhen të gjitha krijesat për të bërë diçka që të ndodhë, të cilën Allahu nuk e ka shkruajtur për të ndodhur, ata nuk do të arrijnë ta bëjnë që të ndodhë.

جفَّ القلمُ بما هو كائنٌ إلى يومِ القيامةِ

❖ Është tharë boja e Penës pasi që u shkruajt ajo që do të ndodhë gjer në Ditën e Kijametit.

وما أخطأ العبدَ لم يكنْ ليصيبه، وما أصابه لم يكنْ ليخطئه

❖ Çdo gjë që nuk i ka rënë robit, ajo kurrë s'do të kishte mundur t'i binte atij; dhe çdo gjë që i ka rënë robit, ajo kurrë nuk mund t'i shmangej atij.

وعلى العبدِ أن يعلمَ أن اللهَ قد سبقَ علمُه في كلِّ كائنٍ من خلقه، فقدَّرَ ذلكَ تقديرًا محكمًا مبرمًا ليس فيه ناقصٌ ولا معقبٌ ولا مزيلٌ ولا مغيرٌ ولا محوّلٌ ولا ناقصٌ ولا زائدٌ من خلقه في سماواته وأرضيه

❖ Robi e ka detyrë që ta dijë se Allahu ka paraprirë me Dijen e Tij çdo gjë që do të ndodhë në krijesat e Tij dhe e paracaktoi atë me paracaktim preciz e të pakthyeshëm, të cilin askush nga krijesat e Tij në qiejt apo në tokën e Tij nuk mund ta anulojë apo të bashkangjisë diçka tjetër në të apo ta fshijë apo ta ndryshojë apo ta mangësojë apo të shtojë mbi të.

وذلك من عَقْدِ الإِيمَانِ وَأَصُولِ الْمَعْرِفَةِ وَالْإِعْتِرَافِ بِتَوْحِيدِ اللَّهِ تَعَالَى  
وَرُبُوبِيَّتِهِ، كَمَا قَالَ تَعَالَى فِي كِتَابِهِ: {وَخَلَقَ كُلَّ شَيْءٍ فَقْدَرَهُ تَقْدِيرًا}،  
وَقَالَ تَعَالَى: {وَكَانَ أَمْرُ اللَّهِ قَدْرًا مَقْدُورًا}

❖ Dhe kjo është prej lidhjeve më të forta të Imanit dhe prej parimeve themelore të njohjes dhe pranimit të Teuhidit dhe Rububijes së Allahut të Shtësuar, sikurse ka thënë i Shtësuari në Sibrin e Tij: “Dhe Ai krijoi çdo gjë dhe i dha përcaktim të detajuar.” [el-Furkan, 2] Dhe ka thënë i Shtësuari: “Dhe urdhëri i Allahut është përherë vendim i pakthyeshëm.” [el-Ahzab, 38]

فَوَيْلٌ لِمَنْ صَارَ لِلَّهِ تَعَالَى فِي الْقَدَرِ خَصِيمًا، وَأَحْضَرَ لِلنَّظَرِ فِيهِ قَلْبًا سَقِيمًا، لَقَدْ  
التَّمَسَّ بِوَهْمِهِ فِي فَحْصِ الْغَيْبِ سِرًّا كَتِيمًا، وَعَادَ بِمَا قَالَ فِيهِ أَفَاكًا أَثِيمًا

❖ Andaj, mjerë për atë që i kundërvihet Allahut për Kaderin, dhe futet në çështjen e tij me një zemër të sëmurë, pasi ai përpiqet me mendjen e tij që të hulumtojë Gjajbin që është i fshehtë dhe i vulosur, dhe duke folur për Kaderin ai shndërrohet në shpifës gjynahqar.

والعرشُ والكرسيُّ حقٌّ

❖ Arshi dhe Kursij-a janë të vërteta.

وهو مستغن عن العرش وما دونه

❖ Dhe Ai është i Panevojshëm për Arshin e për gjithçka tjetër poshtë tij.

محيطٌ بكلِّ شيءٍ وفوقه

❖ Ai ka nën kontroll gjithçka me Dijen dhe Fuqinë e Tij dhe Ai qëndron mbi krijesat e Tij.

وقد أعجزَ عن الإحاطةِ خلقه

❖ Dhe Ai i ka bërë të paafta krijesat e Tij që ta përfshijnë Atë me dijen e tyre.

ونقول: إِنَّ اللَّهَ اتَّخَذَ إِبْرَاهِيمَ خَلِيلاً، وَكَلَّمَ اللَّهُ مُوسَى تَكْلِيمًا إيمَانًا وَتَصَدِيقًا وَتَسْلِيمًا

❖ Dhe ne themi duke besuar, duke pohuar dhe duke pranuar me nënshtrim se Allahu e bëri Ibrahimin mik të dashur dhe Allahu i foli Musait drejtpërdrejtë.

وَنُؤْمِنُ بِالْمَلَائِكَةِ وَالنَّبِيِّينَ، وَالْكِتَابِ الْمُنزَّلَةِ عَلَى الْمُرْسَلِينَ، وَنَشْهَدُ أَنَّهُمْ كَانُوا عَلَى الْحَقِّ الْمُبِينِ

❖ Dhe besojmë MelaiKET, Pejgamberët dhe Sibrat që iu zbritën të Dërguarve dhe dëshmojmë se ata ishin në të vërtetën e qartë.

وَنَسْمِي أَهْلَ قِبَلَتِنَا مُسْلِمِينَ مُؤْمِنِينَ، مَا دَامُوا بِمَا جَاءَ بِهِ النَّبِيُّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ مُعْتَرِفِينَ، وَلَهُ بِكُلِّ مَا قَالَهُ وَأَخْبَرَ مُصَدِّقِينَ غَيْرَ مُنْكَرِينَ

❖ Ne i quajmë ata që falen drejt Kiblës sonë Muslimanë dhe Besimtarë, për sa kohë që e pranojnë Mesazhin me të cilin erdhi Pejgamberi (sal-Allahu 'alejhi ue sel-lem) dhe pohojnë çdo gjë që tha dhe njoftoi ai.



ولا نخوضُ في الله ولا نماري في دين الله. ولا نجادلُ في القرآن، ونشهدُ أنه كلامُ ربِّ العالمين، نزلَ به الروحُ الأمينُ، فعلمه سيدُ المرسلين محمدًا صلى الله عليه وسلم

❖ Dhe ne nuk flasim për Allahun (pa dije) dhe as nuk polemizojmë për Kur'anin, porse dëshmojmë që ai është Fjala e Zotit të Gjithësisë, me të cilin zbriti Shpirti Besnik (Xhibrili 'alejhis-selam) dhe ia mësoi Zotërisë së të Dërguarve, Muhamedit (*sal-l'Allahu 'alejhi ue sel-lem*).

وهو كلامُ الله تعالى، لا يساويه شيءٌ من كلامِ المخلوقين

❖ Ai (Kur'ani) është Fjala e Allahut të Cartësuar dhe asnjë fjalë e krijesave nuk është e njëjtë me të.

ولا نقولُ بخلقه، ولا نخالفُ جماعة المسلمين

❖ Ne nuk themi që ai është i krijuar dhe nuk e kundështojmë Xhematin e Muslimanëve.

ولا نكفرُ أحدًا من أهل القبلة بذنبٍ ما لم يستحلّه

❖ Dhe ne nuk bëjmë qafir askënd prej njerëzve të Kiblës për shkak të gjynahut, për sa kohë që ai nuk e bën të lejuar atë gjynah.<sup>5</sup>

---

<sup>5</sup> [Komentoi Shejkh 'Abdul-'Aziiz Ibën Baz \(rahimehullah\) duke thënë:](#)

Me fjalën e tij: “Dhe ne nuk bëjmë qafir askënd prej njerëzve të Kiblës për shkak të gjynahut, për sa kohë që ai nuk e bën të lejuar atë gjynah”, ai ka për qëllim - Allahu pastë mëshirë për të - se Ehli-Suneti dhe Xhemati nuk bëjnë qafir Muslimanin që është me Teuhid dhe beson në Allahun dhe në Ditën e Gjykimit për shkak të një gjynahu që bën ai, si për shembull zinaja, konsumimi i pijeve dehëse, kamata, mosbindja ndaj prindërve dhe gjynahe të tjera, përderisa ai nuk i bën të lejuara ato, sepse nëse i bën të lejuara ka bërë kufër, për shkak se ai përgënjeshton Allahut dhe të Dërguarin e Tij dhe ka



ولا نقولُ لا يضرُ مع الإيمانُ ذنبٌ لمن عملهُ

❖ Dhe ne nuk themi që Imani i robit nuk dëmtohet nga gjynahu që ai bën.

نرجو للمحسنين من المؤمنين أن يعفوا عنهم ويدخلهم الجنة برحمته ولا نأمنُ عليهم، ولا نشهدُ لهم بالجنةِ

❖ Ne shpresojmë për vepërmirët nga mesi i Besimtarëve se Allahu do t'i falë dhe do t'i fusë në Xhennet me mëshirën e Tij, porse nuk jemi garant për ata dhe as nuk dëshmojmë për ata se janë në Xhennet.<sup>6</sup>

---

dalë nga feja e tij. Ama, nëse ai nuk i bën të lejuara ato, ai nuk ka bërë kufër sipas Ehli-Sunetit dhe Xhematit, porse është me iman të dobët dhe merr gjykimin sipas gjynahut që ka bërë, duke u emërtuar gjynahqar e duke zbatuar mbi të masat ndëshkimore e masa të tjera që kanë ardhur në Sheriatin e pastër. Dhe kjo është fjala e Ehli-Sunetit dhe Xhematit, ndryshe nga Khauarixhët, nga Muëtezilet dhe nga ata që ndoqën rrugën e tyre të pabazë, sepse Khauarixhët të bëjnë qafir për shkak të gjynaheve, kurse Muëtezilet e vendosin atë në një gradë ndërmjet dy gradave, domethënë në dynja e vendosin ndërmjet Islamit dhe kufrit, kurse për në Botën Tjetër ata pajtohen me Khauarixhët se ai do të jetë përgjithmonë në Zjarr. Dhe fjala e të dyja këtyre grupeve është e pavërtetë sipas Kur'anit, sipas Sunetit dhe sipas Ixhmasë (unanimitetit) të Selefëve të Umetit. Kjo çështje iu është pështjelluar disa njerëzve për shkak të dijes së tyre të paktë, mirëpo gjithësesi ajo është e qartë tek pasuesit e Hakut, sikurse edhe e sqaruam. Dhe sukcesi është nga Allahu.

<sup>6</sup> [Komentoi Shejkh 'Abdul-'Aziz Ibën Baz \(rahimehullah\) duke thënë:](#)

Ai (*rahimehullah*) ka për qëllim çdonjeri, me përjashtim të atyre për të cilët ka dëshmuar i Dërguari (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*) se janë në Xhennet, siç janë Dhjetë të Përgëzuarit dhe të tjerë si ata. Kjo do të përmendet më mbas në fund të fjalës së tij, dhe duhet patur parasysh që besimi i Ehli-Sunetit dhe Xhematit është se ata dëshmojnë se besimtarët dhe të devotshmit në përgjithësi janë prej banorëve të Xhennetit, dhe se mosbesimtarët, idhujtarët

ونستغفرُ لمسيئتهم ونخافُ عليهم ولا نُقِطُهُم

❖ Ne kërkojmë falje për ata që kanë bërë gjynahe dhe kemi frikë për ta, porse nuk i bëjmë ata që ta humbasin shpresën (nga Mëshira e Allahut).

والأمنُ والإياسُ ينقلان عن ملة الإسلام، وسبيلُ الحق بينهما لأهل القبلة

❖ Të ndjehesh i siguruar (nga Dënimi i Allahut) dhe të humbasësh shpresën (nga Mëshira e Allahut), të dyja këto të nxjerrin nga feja Islame, ndërsa rruga e vërtetë për Muslimanët qëndron midis atyre të dyjave.

ولا يخرجُ العبدُ من الإيمان إلا بـجُودٍ ما أدخله فيه

❖ Nuk del njeriu nga Imani përveç se me mohimin e asaj që e futi atë në Iman.<sup>7</sup>

---

dhe munafikët janë prej banorëve të Zjarrit, sikurse e tregojnë këtë ajetet fisnike dhe Suneti autentik i të Dërguarit të Allahut (*sallAllahu ‘alejhi ue sellem*). Prej atyre është Fjala e të Përsosurit nga çdo e metë: “Vërtet, të devotshmit do të jenë në Xhenete e në lumturi.” [et-Tuur, 17] Dhe Fjala e Allahu ‘Azze ue Xhel-le: “Allahu u ka premtuar besimtarëve dhe besimtareve kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe ku do të banojnë përgjithmonë.” [et-Teubeh, 72] Ka ajete të shumta që tregojnë këtë kuptim. Dhe për mosbesimtarët është Fjala e të Përsosurit nga çdo e metë: “Për jobesimtarët është përgatitur Zjarri i Xhehenemit, ku ata nuk do të vdesin dhe as që do t’u lehtësohet dënimi. Ja, kështu Ne do t’i dënojmë mosmirënjohësit.” [Fatir, 36] Dhe Fjala e të Përsosurit nga çdo e metë: “Pa dyshim që hipokritët do të jenë në thellësinë më të madhe të Xhehenemit dhe ti kurrësi nuk do t’u gjesh atyre ndihmës.” [en-Nisa`, 145] Ka edhe ajete të tjera që tregojnë këtë kuptim. Dhe sukcesi është nga Allahu.

<sup>7</sup> [Komentoi Shejkh ‘Abdul-‘Aziz Ibën Baz \(rahimehullah\) duke thënë:](#)  
Ka vërejtje për këtë kufizim, ngase mosbesimtari hyn në Islam me dy

وَالْإِيمَانُ هُوَ الْإِقْرَارُ بِاللِّسَانِ وَالتَّصْدِيقُ بِالْجَنَانِ

❖ Dhe Imani është: pohimi me gjuhë dhe besimi me zemër.<sup>8</sup>

dëshmitë, nëse nuk i ka thënë ato. E nëse i thotë ato hyn në Islam duke bërë pendimin që obligon kufri i tij. E në të vërtetë ai mund të dalë nga Islami edhe pa bërë mohim (*xhuhuud*), mund të dalë për shkaqe të shumta, të cilat i kanë sqaruar njerëzit e dijes në kapitullin e murrteedit (felëshuesit), prej të cilave është: sharja e Islamit apo e Pejgamberit (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*), ose tallja me Allahun, me të Dërguarin e Tij, me Librin e Tij ose me diçka prej Sheriatit të Allahut të Përsosur nga çdo e metë, për arsye se i Përsosuri nga çdo e metë ka thënë: **“Thuaj: A mos vallë me Allahun, shpalljet dhe të Dërguarin e Tij po talleni?” Mos u shfajësoni! Ju mohuat, pasi patët besuar.** [et-Teubeh, 65-66] E prej atyre është adhurimi i idhujve dhe krijesave (të gjalla apo të vdekura), ose lutja drejtuar të vdekurve dhe kërkimi i ndihmës në vështirësi apo në rehati nga ata etj., sepse kjo e anulon fjalën **La ilahe il-lAllah**, pasi kjo fjalë tregon që adhurimi është e drejtë që i takon vetëm Allahut, e prej adhurimit është lutja, kërkimi i ndihmës në vështirësi, rukuja, sexhdeja, prerja e kurbanit, zotimi etj. Dhe kush i dedikon diçka prej adhurimit dikujt tjetër në vend të Allahut, qoftë nëse ia dedikon ndonjë idhulli apo ndonjë krijese si melaiket, xhindët, të vdekurve në varre apo krijesave të tjera, ai padyshim që i ka bërë shirk Allahut dhe nuk e ka realizuar fjalën **La ilahe il-lAllah**. Dhe të gjitha këto çështje të nxjerrin nga Islami me ixhmanë (unanimitetin) e njerëzve të dijes, dhe ato nuk janë prej çështjeve të mohimit [*el-xhuhuud*]. Dhe argumentet për to janë të njohura, nga Kur'anit dhe Suneti. Ka edhe çështje të tjera, të shumta, me të cilat Muslimani bën kufër, dhe ato çështje nuk quhen “*xhuhuud*” [mohim]. Ato i kanë përmendur dijetarët në kapitullin e murrteedit, andaj kthehu tek fjalët e tyre nëse dëshiron. Dhe suksesi është nga Allahu.

<sup>8</sup> **Komentoi Shejkh 'Abdul-'Aziz Ibën Baz (*rahimehullah*) duke thënë:**

Ka vërejtje për këtë përkufizim dhe në të ka mangësi. Përkufizimi i saktë është ai i Ehli-Sunetit dhe Xhematit, se Imani është fjalë, vepër dhe besim, shtohet me bindje (ndaj Allahut) dhe pakësohet nga gjynahet. Dhe argumentet për këtë nga Kur'anit dhe Suneti janë të shumta që t'i numërojmë. Dhe ka përmendur shpjeguesi (i Tahauijes), Ibën Ebil-'Izz një pjesë të atyre argumenteve, prandaj referoju atyre nëse dëshiron. Përrjashtimi i veprës nga

وجميع ما صحَّ عن رسول الله صلى الله عليه وسلم من الشرع والبيان كله حقٌ

❖ Dhe çdo sqarim apo ligj që ka ardhur me transmetim të saktë nga i Dërguari i Allahut (*sal-Allahu 'alejhi ue sel-lem*) është i gjithi i vërtetë.

والإيمانُ واحدٌ، وأهله في أصله سواءٌ، والتفاضلُ بينهم بالحسبية والثقى ومخالفة الهوى وملازمة الأولى

❖ Imani është një<sup>9</sup> dhe njerëzit e Imanit në themelin e tij janë të gjithë njësoj dhe ata ia kalojnë njëri-tjetrit me frikë, me devotshmëri, me kundërshtimin e epshit dhe me kapjen mbas asaj që është më e mira.

والمؤمنونَ كلُّهم أولياءُ الرحمن، وأكرمهم عند الله أطوعهم وأتبعهم للقرءان

❖ Të gjithë Besimtarët janë eulija (të dashur) të Allahut dhe më i nderuari prej tyre tek Allahu është ai që bindet dhe pason Kur'anin më së shumti.

---

Imani është fjalë e Murrxhiave, dhe mospajtimi midis tyre dhe Ehli-Sunetit nuk është mospajtim shprehimor, porse është mospajtim shprehimor dhe kuptimor, dhe mbi të zbatohen dispozitat e shumta të cilat i njeh ai që ka studjuar me kujdes fjalën e Ehli-Sunetit dhe Xhematit, si dhe fjalën e Murrxhiave. Allahu na qoftë në ndihmë.

<sup>9</sup> [Komentoi Shejkh 'Abdul-'Aziz Ibën Baz \(rahimehullah\) duke thënë:](#)

Tek fjala e tij “**Imani është një dhe njerëzit e Imanit në themelin e tij janë të gjithë njësoj**” ka vërejtje, madje ajo është *batil* (e pavërtetë). Sepse njerëzit e Imanit nuk janë të gjithë njësoj me iman, porse midis tyre ka diferenca të mëdha, sepse nuk është imani i të Dërguarve sikurse imani i njerëzve të tjerë, ashtu siç nuk është imani i Prijësave të Drejtë dhe pjesës tjetër të Sahabëve (*radij-Allahu 'anhum*) sikurse imani i njerëzve të tjerë. E po kështu, nuk është imani i besimtarëve i njëjtë me imanin e gjynahqarëve, dhe kjo diferencë është në varësi të dijes që ka zemra rreth Allahut, Emrave dhe Cilësive të Tij dhe ligjeve që ka vendosur Ai për robërit e Tij. Dhe kjo është fjala e Ehli-Sunetit dhe Xhematit, ndryshe nga Murrxhiat dhe ata që kanë thënë të njëjtën fjalë sikur ata. Dhe Allahu na qoftë në ndihmë.

والإيمانُ هو الإيمانُ بالله، وملائكته، وكتبه، ورسله، واليوم الآخر، والقدر خيره وشره وحلوه ومُرّه من الله تعالى، ونحن مؤمنون بذلك كله

❖ Imani është: të besosh Allahun, melaiket e Tij, Librat e Tij, të Dërguarit e Tij, Ditën e Kijametit, Kaderin me të mirën dhe të keqen e tij, të ëmblën dhe të hidhurën e tij, që vijnë nga Allahu i Cartësuar; dhe ne i besojmë të gjitha këto.

لا نفرقُ بين أحد من رسله ونصدّقهم كلهم على ما جاءوا به

❖ Ne s'bëjmë dallim tek ndonjë prej të Dërguarve, por besojmë tek të gjithë ata dhe tek mesazhi me të cilin u dërguan.

وأهل الكبائر من أمة محمد صلى الله عليه وسلم في النار لا يخلدون إذا ماتوا وهم موحدون وإن لم يكونوا تائبين بعد أن لقوا الله عارفين مؤمنين، وهم في مشيئته وحكمه إن شاء غفر لهم وعفا عنهم بفضلِهِ، كما ذكر عز وجل في كتابه: {ويغفر ما دون ذلك لمن يشاء}، وإن شاء عذبهم في النار بعدلِهِ ثم يخرجهم منها برحمته وشفاعة الشافعين من أهل طاعته ثم يبعثهم إلى جنّته، وذلك بأن الله تعالى تولى أهل معرفته ولم يجعلهم في الدارين كأهل نُكرته الذين خابوا من هدايته ولم ينالوا من ولايته

❖ Ata që kanë bërë gjynahe të mëdha (nga Umeti i Muhamedit *sal-Allahu 'alejhi ue sel-lem*) nuk do të jenë përgjithmonë në Zjarr, nëse ata vdesin në Teuhid, edhe nëqoftëse nuk janë penduar. Përderisa ata e takojnë Allahun duke e njohur Atë (duke besuar në Të), ata janë nën Dëshirën dhe Gjykimin e Tij. Nëse Ai do i fal dhe ua shlyen gjynahet me Mirësinë e Tij, siç e përmend Allahu Krenar e Madhështor në Librin e Tij: "...por gjynahet e tjera (përveç Shirkut) ia fal kujt të dojë Ai." [en-Nisaa`48] E nëse do, Ai i dënon ata në Zjarr me Drejtësinë e Tij. Pastaj Ai i nxjerr

ata nga Zjarri me Mëshirën e Tij dhe me ndërmjetësimin e ndërmjetësuesve që janë të bindur ndaj Tij dhe pastaj i çon në Xhenetin e Tij. Kjo për arsye se Allahu i Cartësuar është Mbrojtësi i atyre që e njohën Atë dhe nuk do t'i trajtojë ata në dy vendbanimet (sh.p. në dynja dhe në Ahiret) sikurse ata që e mohuan Atë, ata të cilët dështuan në Udhëzimin e Tij dhe nuk e arritën dot Mbrojtjen e Tij.

اللهم يا وليَّ الإسلام وأهله ثبتنا على الإسلام حتى نلقاك به

❖ O Allah, o Mbrojtësi i Islamit dhe i Muslimanëve, na bëj të palëkundur në Islam derisa të takohemi me Ty duke qenë në Islam.

ونرى الصلاة خلف كل برّ وفاجر من أهل القبلة، وعلى من مات منهم

❖ Ne besojmë se namazi duhet të falet mbas çdo Muslimani që është punëmirë apo gjynahqar, si dhe t'i falim xhenazen secilit prej tyre që vdes.

ولا ننزلُ أحدًا منهم جنةً ولا نارًا، ولا نشهدُ عليهم بكفرٍ ولا بشركٍ ولا بنفاقٍ ما لم يظهر منهم شيءٌ من ذلك، ونُدّر سرائرهم إلى الله تعالى

❖ Ne nuk vendosim asnjërin prej tyre në Xhenet apo në Zjarr dhe as nuk i akuzojmë ata për kufër, shirk apo nifak përderisa nuk shfaqin haptazi ndonjë prej tyre, kurse të fshehtat e tyre ia lëm Allahut të Cartësuar.

ولا نرى السيفَ على أحدٍ من أمةٍ محمدٍ صلى الله عليه وسلم إلا من وجبَ عليه السيفُ

❖ Ne besojmë se nuk lejohet ngritja e shpatës kundër dikujt nga Umeti i Muhamedit (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*), me përjashtim të atyre, kundër të cilëve është obligim përdorimi i shpatës.



ولا نرى الخروجَ على أئمتنا وولاية أمورنا وإن جاروا، ولا ندعو عليهم، ولا ننزغُ يداً من طاعتهم، ونرى طاعتهم من طاعة الله عز وجل فريضة ما لم يأمرُوا بمعصية. وندعو لهم بالصلاح والمعافاة

❖ Ne besojmë se nuk lejohet kryengritja ndaj udhëheqësve dhe drejtuesve të punëve tona, edhe nëqoftëse ata bëjnë padrejtësi, dhe as nuk bëjmë dua kundër tyre, as nuk e heqim dorë së binduri ndaj tyre, porse besojmë se bindja ndaj tyre është bindje ndaj Allahut ('*Azze ue Xhel-le*), e detyrueshme, për sa kohë që ata nuk urdhërojnë për mosbindje ndaj Allahut; si dhe bëjmë dua për përmirësimin dhe mirëqënien e tyre.

ونتبِعُ السُّنَّةَ والجماعةَ، ونجتنبُ الشذوذَ والخلافَ والفرقةَ

❖ Ne pasojmë Sunetin dhe Xhematin dhe qëndrojmë larg devijimeve, mospajtimit dhe përcarjes.

ونحبُّ أهلَ العدلِ والأمانةِ ونبغضُ أهلَ الجورِ والخيانةِ

❖ Ne i duam njerëzit e drejtësisë dhe besës, dhe i urrejtmë njerëzit e padrejtësisë dhe tradhëtisë.

ونقولُ اللهُ أعلمُ فيمَ اشْتَبَهَ علينا علمُهُ

❖ Ne themi "Allahu e di më së miri" kur kemi diçka të paqartë.

ونرى المسحَ على الخفينِ في السفرِ والحَضَرَ كما جاء في الأثر

❖ Ne besojmë në ligjshmërinë e fshirjes mbi meste kur udhëton apo kur nuk udhëton, sikurse ka ardhur në hadithe.

والحجُّ والجهادُ ماضيان مع أولي الأمر من المسلمين برَّهم وفاجرهم إلى قيام الساعة لا يبطلهما شيءٌ ولا ينقضهما

✿ **Haxhi dhe Xhibadi do të vazhdojnë deri në Orën e Fundit, nën drejtimin e udhëheqësit të Muslimanëve, goftë punëmirë apo i prishur, dhe asgjë nuk mund t'i zhvlerësojë apo t'i anulojë ato të dyja.**

ونؤمنُ بالكرامِ الكاتبين، فإنَّ الله قد جعلهم علينا حافظينَ

✿ **Ne besojmë në Shkruesit e Nderuar (sh.p. Melaiket), ngase Allahu i ka vendosur ata që të na mbikqyrin.**

ونؤمنُ بملكِ الموتِ الموكلِ بقبضِ أرواحِ العالمينِ

✿ **Dhe besojmë në Melekun e Vdekjes, i cili është i ngarkuar me detyrën e marrjes së shpirtave të krijesave (sh.p. xhindëve dhe njerëzve).**

وبعذابِ القبرِ لمن كان له أهلاً، وسؤالِ منكرٍ ونكيرٍ في قبره عن ربه ودينه  
ونبيه على ما جاءت به الأخبارُ عن رسولِ الله صلى الله عليه وسلم وعن  
الصحابَةِ رضوانُ الله عليهم

✿ **Besojmë në Dënimin e Varrit për ata që do ta meritojnë, si dhe pyetjet e Nekirit dhe Munkerit që ia bëjnë të vdekurit në varr për Zotin e tij, për Fenë e tij dhe për Pejgamberin e tij, sikurse ka ardhur në hadithet e të Dërguarit të Allahut (*sal-lallahu 'alejhi ue sel-lem*) dhe nga Sahabët, Allahu goftë i kënaqur me ta.**

والقبرِ روضةً من رياضِ الجنةِ أو حفرةً من حفرِ النيرانِ

✿ **Varri është kopësht prej kopështeve të Xhenetit ose gropë prej gropave të Zjarrit.**



ونؤمنُ بالبعثِ وجزاءِ الأعمالِ يومَ القيامةِ والعرضِ والحسابِ وقراءةِ الكتابِ  
والتوابِ والعقابِ والصراطِ والميزانِ

❖ Ne besojmë në Ringjalljen, në shpërblimin e veprave Ditën e Gjykimit, në paraqitjen e veprave dhe marrjen në llogari, në leximin e librit të veprave, në shpërblimin dhe dënimin, në Siratin dhe Peshoren.

والجنة والنارُ مخلوقتان لا تفنيان أبداً ولا تبيدان، وأن الله تعالى خلق الجنة والنارَ قبل الخلق وخلقَ لهما أهلاً، فمن شاءَ منهم إلى الجنة فضلاً منه، ومن شاءَ منهم إلى النارِ عدلاً منه

❖ Xheneti dhe Zjarri janë të krijuara tashmë dhe nuk do të shuhen kurrë dhe nuk do të mbarojnë, dhe se Allahu e krijoi Xhenetin dhe Zjarrin përpara krijesave, dhe krijoi banorët për secilën prej atyre të dyjave; kë të dëshirojë Ai e bën prej banorëve të Xhenetit me Mirësinë e Tij, dhe kë të dëshirojë Ai e bën prej banorëve të Zjarrit me Drejtësinë e Tij.

وكلُّ يعملُ لما قد فرغَ له وصائرُ إلى ما خُلِقَ له

❖ Çdokush do të bëjë ato vepra të cilat i janë paracaktuar dhe do të shkojë drejt asaj për të cilën është krijuar.

والخيرُ والشرُّ مقدران على العباد

❖ Ë mira dhe e keqja janë të paracaktuara për robërit.

والاستطاعةُ التي يجبُ بها الفعلُ من نحو التوفيقِ الذي لا يجوزُ أن يوصفَ المخلوقُ بهُ فهي معَ الفعلِ، وأما الاستطاعةُ من جهةِ الصحةِ والوسعِ والتمكُنِ وسلامةِ الآلاتِ فهي قبلَ الفعلِ، وبها يتعلّقُ الخطابُ، وهي كما قالَ تعالى:  
{ لا يكلفُ الله نفساً إلا وسعها }

❖ Takati për të bërë punën është sukses nga Allahu dhe nuk lejohet të cilësohet krijesa me të sepse takati shkon bashkë me punën. Ndërsa takati në aspektin e shëndetit, aftësisë, mundësisë dhe mirëqënies së organeve është përpara punës dhe me të lidhet kërkesa. Dhe kërkesa është ashtu siç ka thënë i Cartësuar: “Allahu nuk e ngarkon askënd përtej fuqisë që ka.” [el-Bekarah, 286]

وأفعالُ العبادِ خلقُ الله وكسبُ من العبادِ

❖ Veprat e robërve janë të krijuara nga Allahu dhe të fituara nga robërit.

ولم يكلفهمُ اللهُ تعالى إلا ما يطيقون، ولا يطيقونَ إلا ما كُفِّهم، وهو تفسير "لا حول ولا قوة إلا بالله" نقول: لا حيلة لأحدٍ ولا حركة لأحدٍ ولا تحولٌ لأحدٍ عن معصيةِ الله إلا بمعونةِ الله، ولا قوة لأحدٍ على إقامةِ طاعةِ الله والثباتِ عليها إلا بتوفيقِ الله

❖ Dhe Allahu i Cartësuar nuk i ngarkon ata përtej takatit të tyre dhe ata janë të aftë që të bëjnë veçse atë që u është ngarkuar<sup>10</sup>, dhe ky është shpjegimi i fjalës “*La haula ue la kuwete il-la bill-lah* – S’ka ndryshim dhe fuqi përveç se nga Allahu”. Ne themi: s’ka largim për askënd, s’ka lëvizje për askënd, s’ka ndryshim për askënd nga mosbindja ndaj Allahut, përveç se me ndihmën e Allahut; dhe s’ka fuqi për askënd për të kryen bindjen ndaj Allahut dhe për të qenë i patundur në të, përveç se me suksesin e Allahut.

---

<sup>10</sup> [Komentoi Shejkh ‘Abdul-‘Azizj Ibën Baz \(\*rahimehullah\*\) duke thënë:](#)

Kjo është e pasaktë, përkundrazi, ata që janë të ngarkuar kanë takat të bëjnë më shumë nga ato që ua ngarkoi i Përsosuri nga çdo e metë. Mirëpo Allahu (‘Azze ue Xhelle) u tregua i Butë me robërit e Tij dhe i lehtësoi dhe nuk u vuri ndonjë vështirësi në fenë e tyre, nga Mirësia dhe Bamirësia e Tij. Dhe Allahu është Dhënësi i suksesit.

وكلُّ شيءٍ يجري بمشيئةِ اللهِ تعالى وعلمِهِ وقضائِهِ وقَدْرِهِ

❖ Dhe çdo gjë ndodh me Dëshirën e Allahut të Shtëruar, me Dijen e Tij, me Caktimin e Tij dhe me Fuqinë e Tij.

غلبت مشيئته المشيئاتِ كلها

❖ Dëshira e Tij mposht të gjitha dëshirat.

و غلب قضاؤه الحيلَ كلها

❖ Dhe Caktimi i Tij mposht të gjitha përpjekjet.

يفعلُ ما يشاءُ وهو غيرُ ظالمٍ أبداً، تقدَّسَ عن كلِّ سوءٍ وحَيْنٍ، وتنزَّهَ عن كلِّ عيبٍ وشَيْنٍ { لا يسئَلُ عما يفعلُ وهم يسئَلون }.

❖ Ai bën çfarë të dojë dhe nuk është i padrejtë asnjëherë. [Ai është i pastër nga çdo e keqe dhe nga çdo mbarim, dhe larg çdo gabimi dhe të metë.] “Ai nuk pyetet për atë që punon, kurse ata do të pyeten.” [el-Enbija` , 23]

وفي دعاءِ الأحياءِ وصدقاتِهِمْ منفعَةٌ للأموالِ

❖ Në lutjen dhe lëmshën e të gjallëve ka dobi për të vdekurit.

واللهُ تعالى يستجيبُ الدعواتِ ويقضي الحاجاتِ

❖ Allahu i Shtëruar i përgjigjet lutjeve dhe i plotëson nevojat.

و يملكُ كلَّ شيءٍ ولا يملكُهُ شيءٌ

❖ Ai zotëron gjithçka dhe askush nuk e zotëron Atë.

ولا غنى عن الله تعالى طرفة عين

❖ Askush nuk mund të bëjë pa Allahun e Cartësuar, qoftë edhe sa një lëvizje të qepallës së syrit.

ومن استغنى عن الله طرفة عين فقد كفر وصار من أهل الحين

❖ Dhe kushdo që mendon se mund të bëjë pa Allahun e Cartësuar, qoftë edhe sa një lëvizje të qepallës së syrit, ai ka bërë kufër dhe është prej njerëzve të rrënimit.

والله يغضب ويرضى لا كأحد من الورى

❖ Allahu zemërohet dhe kënaqet, por jo ashtu si krijesat.

ونحب أصحاب رسول الله صلى الله عليه وسلم، ولا نفرط في حب أحد منهم،  
ولا نتبرأ من أحد منهم

❖ Ne i duam Shokët e të Dërguarit të Allahut (*sal-l'Allahu 'alejhi ue sel-lem*) dhe nuk i kalojmë kufijtë në dashurinë që kemi për ndonjërin prej tyre dhe as nuk distancohemi nga ndonjëri prej tyre.

ونبغض من يبغضهم وبغير الخير يذكرهم

❖ Ne e urrejmë atë që i urren ata dhe që nuk i përmend për mirë.

ولا نذكرهم إلا بخير وحبهم دين وإيمان وإحسان وبغضهم كفر ونفاق وطغيان

❖ Ne nuk i përmendim Sahabët përveçse për mirë dhe dashuria për ta është prej Fesë, prej Imanit dhe Ihsanit, ndërsa urrejtja ndaj tyre është kufër, nifak dhe kalim i kufijve.

ونثبتُ الخلافةَ بعد رسول الله صلى الله عليه وسلم أولاً لأبي بكر الصديق رضي الله عنه، تفضيلاً له وتقديماً على جميع الأمة. ثم لعمر بن الخطاب رضي الله عنه، ثم لعثمان بن عفان رضي الله عنه، ثم لعلي بن أبي طالب رضي الله عنه وهم الخلفاء الراشدون والأئمة المهتدون

❖ Ne pohojmë udhëheqjen mbas të Dërguarit të Allahut (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*), së pari për Ebu Bekr es-Siddijk (*radij-Allah'u 'anhu*) pasi ai është më i miri dhe i prin të gjithë Umetin; pastaj për 'Umer Ibnul-Khattab (*radij-Allah'u 'anhu*), pastaj për 'Uthman Ibën 'Affan (*radij-Allah'u 'anhu*) dhe pastaj për 'Alij Ibën Ebij Talib (*radij-Allah'u 'anhu*). Dhe ata janë Prijësat e Drejtë dhe Imamët e Udhëzuar.

وإن العشرة الذين سماهم رسولُ الله صلى الله عليه وسلم وبشرهم بالجنة، نشهد لهم بالجنة على ما شهد لهم رسولُ الله صلى الله عليه وسلم، وقوله الحق، وهم: أبو بكر، وعمر، وعثمان، وعلي، وطلحة، والزبير، وسعد، وسعيد، وعبد الرحمن بن عوف، وأبو عبيدة بن الجراح، وهو أمينُ هذه الأمة رضي الله عنهم أجمعين

❖ Për dhjetë Sahabët të cilëve ua përmendi emrat i Dërguari i Allahut (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*) dhe dëshmoi për ta se janë prej banorëve të Xhenetit, ne dëshmojmë se ata janë në Xhenet përderisa dëshmoi për ta i Dërguari i Allahut (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*) dhe fjala e tij është e vërtetë. Dhe ata janë: Ebu Bekri, 'Umeri, 'Uthmani, 'Aliu, Talha, Zubejri, Seadi, Se'idi, 'Abdur-Rahman Ibën 'Aufi, Ebu 'Ubejdeh Ibnul-Xherrah - i cili është Besniku i këtij Umeti – Allah'u qoftë i kënaqur me të gjithë ata.

ومن أحسنَ القولَ في أصحاب رسول الله صلى الله عليه وسلم وأزواجه الطاهراتِ من كل دنسٍ وذرياتِه المقدسينَ من كل رجسٍ فقد برئَ من النفاق

❖ Dhe kush flet mirë për Shokët e të Dërguarit të Allahut (*sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem*), për Gratë e tij të pastra nga çdo njollë (sh.p. në nderin e tyre) dhe për pasardhësit e tij të pastër nga çdo poshtërsi, është i pastër nga nifaku.

وعلماء السلف من السابقين ومن بعدهم من التابعين أهل الخير والأثر، وأهل  
الفقه والنظر، لا يُذكرون إلا بالجميل ومن ذكرهم بسوءٍ فهو على غير السبيل

❖ Dhe dijetarët e Selefëve, të mëhershmit dhe të mëvonshmit, prej Tabi'inëve dhe ndjekësve të mirësisë dhe transmetimeve, fukahatë dhe analistët, duhet të përmenden vetëm me fjalë të mira. Dhe kush flet keq për ta, atëherë ai nuk është në Rrugën e Drejtë.

ولا فضلٌ أحدًا من الأولياءِ على أحدٍ من الأنبياءِ عليهم السلام، ونقول نبيُّ  
واحدٌ أفضلٌ من جميع الأولياءِ

❖ Ne nuk ngremë asnjë prej eulijave mbi ndonjë prej Pejgamberëve (*alejhimus-selam*), porse themi: një Pejgamber i vetëm është më i mirë se të gjithë eulijatë.

نؤمنُ بما جاءَ من كراماتهم، وصحَّحَ عن الثقات من رواياتهم

❖ Dhe ne besojmë kerametet (mrekullitë) e eulijave që kanë ardhur në transmetimet e sakta nga transmetuesit e besueshëm.

ونؤمنُ بأشراطِ الساعةِ من خروجِ الدجال، ونزولِ عيسى ابنِ مريمَ عليه السلام من  
السماء، ونؤمنُ بطلوعِ الشمسِ من مغربها، وخروجِ دابةِ الأرضِ من موضعها

❖ Dhe besojmë shenjat e Orës së Fundit, si: dalja e Dexhalit, zbritja e 'Ijsa Ibën Merjem (*alejhis-selam*) nga qielli, si edhe lindja e Diellit nga perëndimi dhe dalja e Kafshës së Tokës nga strofulla e saj.

ولا نصدِّقُ كاهنًا ولا عرافًا

❖ Ne nuk i besojmë parashikuesit të fatit dhe atij që pretendon se ka dije nga bota e fshehtë.

ولا من يدعي شيئاً يخالف الكتاب والسنة وإجماع الأمة

❖ As nuk i besojmë atij që vjen me diçka që kundërshton Kur'anin, Sunetin dhe Ixhmanë e Umetit.

ونرى الجماعة حقًا وصوابًا، والفرقة زيغًا وعذابًا

❖ Dhe ne besojmë se bashkimi është hak dhe i saktë, ndërsa përçarja është devijim dhe dënim.

ودينُ الله في الأرض والسماء واحدٌ وهو دينُ الإسلام، قال الله تعالى: {إن الدين عند الله الإسلام}. وقال تعالى: {ورضيتُ لكم الإسلامَ دينًا}

❖ Dhe Feja e Allahut në tokë dhe në qiell është një, e ajo është Feja e Islamit. Ka thënë Allahu i Cartësuar: “Feja e vërtetë tek Allahu është vetëm Islami.” [Aali-Imran, 19] Dhe ka thënë i Cartësuari: “Dhe jam i Kënaqur që Islami të jetë feja juaj.” [el-Ma`ideh, 3]

وهو بين الغلو والتقصير، وبين التشبيه والتعطيل، وبين الجبر والقدر،  
وبين الأمن والإياس

❖ Dhe Islami është midis teprimit dhe mangësimit, midis përngjasimit (të Cilësive të Allahut) dhe mohimit, midis fatalizmit (mohimit të lirisë së veprimit njerëzor) dhe mohimit të Kaderit, si dhe midis të qënurit i sigurtë nga Dënimi i Allahut dhe humbjes së shpresës nga Mëshira e Tij.

فهذا ديننا واعتقادنا ظاهرًا وباطنًا، ونحن براءٌ إلى الله من كلِّ من خالف الذي ذكرناه وبيناه

❖ Dhe kjo është Feja jonë dhe Akideja jonë haptazi dhe fshehurazi, dhe ne jemi të pastër nga cilido që kundërshton këto që përmendëm dhe sqaruam.



ونسألُ اللهَ تعالى أن يثبتنا على الإيمان ويختمَ لنا به، ويعصمنا من الأهواءِ  
المختلفة والآراء المتفرقة والمذاهب الرديئة مثل المشبهة والمعتزلة والجهمية  
والجبرية والقدرية، وغيرهم من الذين خالفوا السنة والجماعة،  
وحالفوا الضلالة، ونحن منهم براءٌ وهم عندنا ضالُّلٌ وأردياء.  
وبالله العصمة والتوفيق. انتهى.

❖ Dhe lusim Allahun e Cartësuar që të na bëjë të palëkundur në Iman dhe të na e marrë shpirtin në të, që të na mbrojë nga epshet e ndryshme, mendimet përçarëse dhe drejtimet e këqija, siç janë: Mushebihat (sh.p. ata që i përngjasojnë Cilësitë e Allahut me cilësitë e krijesave), Muëtezilet, Xhehmijet, Xhebrijet, Kaderitë etj., të cilët kundërshtuan Sunetin dhe Xhematin dhe ndoqën devijimin. Ne distancohemi nga ata dhe i konsiderojmë të devijuar dhe të këqinj.

Mbrojtja dhe sukcesi janë nga Allahu.



Përktheu: Alban Malaj  
E Xhuma, 14 Rexheb 1434 Hixhrij/24 Maj 2013 Miladij  
`Auali, Mekkeh



تَمَسِّكَ بِحَبْلِ اللَّهِ وَأَتَّبِعِ الْهُدَى \* \* \* وَلَا تَكُ بِدْعِيًّا لَعَلَّكَ تُفْلِحُ

Kapu pas Qitarit të Allahut dhe ndiqe Udhëzimin,

E mos u bëj Bidatçi, që të arrish Ngadhënjimin,

وَدِينٌ بِكِتَابِ اللَّهِ وَالسُّنَنِ النَّبِيِّ \* \* \* أَتَتْ عَنْ رَسُولِ اللَّهِ تَنْجُو وَتَرْبِحُ

Qe të jetë Feja jote Kur'ani dhe Suneti i Pejgamberit,

Se kështu do të shpëtosh e do të arrish cakun e Fitimit.

*Kur'ani dhe Suneti  
sipas kuptimit të  
Selefëve të këtij Ummeti*



*Selefi.org*